

NJOFTIM

për dhënien e provimit profesional për mësimdhënës dhe bashkëpunëtorë profesional në sesionin e pranverës në vitin 2020

Qendra Shtetërore e Provimeve në harmoni me nenin 2 nga Ligji për mësimdhënës dhe bashkëpunëtorë profesional në shkolla fillore dhe të mesme („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.161/19), organizon provimin profesional për praktikantët të cilët pas skadimit të stazhit të praktikantit janë të detyruar të japin atë.

Këtë sesion provimi Qendra Shtetërore e Provimeve do ta realizojë në periudhën nga **23.3. deri më 30.4.2020.**

Në mbështetje të nenit 11 të Rregullore-s mbi mënyrën dhe procedurën gjatë dhënies së provimit profesional për mësues, arsimtar, bashkëpunëtor profesional dhe edukator në shkollë fillore („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.27/96) dhe nenit 11 të Rregullore-s mbi kushtet dhe mënyrën e dhënies së provimit profesional për arsimtarë dhe bashkëpunëtorë profesional në shkollat e mesme publike („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.27/96), praktikantët e shkollave, të cilët e kanë përfunduar stazhin e praktikantit dhe i plotësojnë kushtet për dhënien e provimit profesional dorëzojnë Fletaplikim për dhënien e provimit profesional me dokumentacionin vijues:

1. **Certifikatë** e përfundimit të stazhit të praktikantit në shkollë në kohëzgjatje prej një viti në të cilën do të shënohet afati gjatë së cilit është zhvilluar stazhi i praktikantit, të vërtetuar me numër arkivor të shkollës në të cilën është zhvilluar stazhi i praktikantit.

2. **Mendim** nga mentori për punën e praktikantit gjatë stazhit të praktikantit, të vërtetuar me numër arkivor të shkollës në të cilën është zhvilluar stazhi i praktikantit.

3. **Mendim** nga organi më i lartë profesional i shkollës në të cilën është i punësuar praktikanti mbi punën e tij edukativo-arsimore, të vërtetuar me numër arkivor të shkollës në të cilën është zhvilluar stazhi i praktikantit.

Shkolla në të cilën punon praktikanti të bëjë verifikimin se për të satën herë (e parë, e dytë etj.) praktikanti i nënshtrohet provimit dhe po të njëjtën e shënon tek mendimi i këshillit arsimor.

4. **Detyrë shtëpie me shkrim** (në dy kopje). Temën e zgjedhur për punimin e detyrës së shtëpisë praktikanti duhet ta hulumtojë dhe përpunojë nga aspekti i zbatimit praktik të saj të drejtpërdrejtë në punën arsimore në fushën më të ngushtë profesionale të praktikantit. Për praktikantët të cilët mësimin e realizojnë në gjuhët e komuniteteve, një kopje të detyrës së shtëpisë me shkrim e dorëzojnë në gjuhën e komunitetit përkatës dhe një kopje në gjuhën maqedonase.

5. Raport nga Fondi për Sigurim Pensional dhe Invalidor i Maqedonisë për stazhin e punës të realizuar të praktikantit në një vit të kalendarit.

6. Diplomë ose Certifikatë e mbarimit të arsimit përkatës (në origjinal ose kopje e vërtetuar në noter).

7. Certifikatë e përgatitjes pedagogjike-psikologjike dhe metodike të marrë në universitet të akredituar (vetëm për praktikantët të cilëve iu duhet përgatitja në fjalë, në përputhje me normativin për kuadër arsimor nga programi arsimor). (në origjinal ose kopje e vërtetuar në noter).

8. Kopje e fletëpagesës së mjeteve të paguara për dhënien e provimit profesional (fletëpagesa në origjinal).

Fletaplikimi me dokumentacionin e kompletuar dorëzohet **VETËM PËRMES POSTËS** pranë Qendrës Shtetërore të Provimeve me adresë në rr. "Vasil Gjorgov" pn., 1000 Shkup, më së voni deri më 10.3.2020 (e martë).

- Praktikantët nga shkollat fillore në fletaplikimin për dhënien e provimit profesional duhet të shënojnë klasën në të cilën realizojnë mësimdhënie dhe lëndën mësimore.
- Praktikantët nga shkollat e mesme në fletaplikimin për dhënien e provimit profesional duhet të shënojnë vitin në të cilin realizojnë mësimdhënie dhe lëndën mësimore.
- Praktikantët nga shkollat e mesme profesionale në fletaplikimin për dhënien e provimit profesional duhet të shënojnë vitin në të cilin realizojnë mësimdhënie, lëndën dhe llojin e profesionit.
- Praktikantët nga shkollat e mesme të artit në fletaplikimin për dhënien e provimit profesional duhet të shënojnë vitin në të cilin realizojnë mësimdhënie, lëndën dhe llojin e artit.

Kandidatët për dhënien e provimit profesional paguajnë mjete në lartësi prej **1.600,00 denarësh (një mijë e gashëqind) denarësh** në fletëpagesën e plotësuar në këtë mënyrë:

Qëllimi i pagesës: Pagesë për provimin profesional të mësimdhënësve-praktikantë në shkolla-sesioni i pranverës 2020;

Emri i pranuesit: Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut;

Banka e pranuesit: Banka popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut;

Llogaria transaksionale:100000000063095;

Llogaria e shfrytëzuesit buxhetor: 1600261506 787 16;

Shifra hyrëse: 723013;

Programi: 30.

VËREJTJE: Pyetjet për verifikimin e diturive të përgjithshme lidhur me rregullativën ligjore-normative dhe të organizimit të veprimtarisë do të jenë nga dispozitat aktuale ligjore nga sfera e arsimit.

Dokumentacioni i pakompletuar dhe i dërguar jo me kohë nuk do të shqyrtohet dhe po ai do të kthehet.

SHËNIM:

- Kandidatët të cilët kanë dorëzuar dokumentacionin e kompletuar për dhënien e provimit profesional pranë Qendrës Shtetërore të Provimeve në sesionin e vjeshtës 2019, dhe kanë **munguar me arsye** duhet të dorëzojnë vetëm fletaplikim të ri për dhënien e provimit profesional.
- Kandidatët të cilët **nuk i kanë plotësuar kushtet** për dhënien e provimit profesional në Qendrën Shtetërore të Provimeve në sesionin e vjeshtës 2019, ndërsa tani i plotësojnë kushtet duhet të dorëzojnë fletëpagesë të re dhe dokumentacion të kompletuar (si më lartë).
- Kandidatët të cilët **nuk e kanë kaluar provimin profesional** në Qendrën Shtetërore të Provimeve në sesionin e vjeshtës 2019, duhet të dorëzojnë fletëpagesë dhe fletëparaqitje të re.

QENDRA SHETETËORE E PROVIMEVE